

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "AB VIZION" Sh.p.k.

Sot, më datë 01/08/2022,

- **Z. Bashkim Teqja**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 10/09/1948, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. Personal E80910087R, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "AB VIZION" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "AB VIZION" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Kostandin Kristoforidhi", Njësia Bashkiake nr.2, Godina nr.4, Kati 4, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Kryerja e veprimtarive në fushën e ndërtimit si projektim, zbatim punimesh si dhe veprimeve të lidhura me to,
- Investim, zhvillim, menaxhim i zonave civile, sociale, turistike, industriale, ura, tunele, vepra arti, komplekse të tregtimit dhe të shërbimit bar-restorant-hoteleri, sinjalistikë etj., si edhe shërbimeve të tjera të veprimtarive tregtare të ngjashme ose të lidhura me to.
- Pjesëmarrje në projekte ndërtimore, si sipërmarrës, investitor.
- Konsulencë për punim, ndërtim, montim të objekteve civile, veprave inxhinierike dhe menaxhim të investimeve.
- Prodhim dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndërtimit, import eksport i tyre brenda dhe jashtë vendit, për llogari të vetë shoqërisë si dhe të tretëve, ku përfshihen inerte, gurë, gurë dekorative, gëlqere, pllaka parafabrikate, llaç, çimento, rërë dhe çdo material tjetër për ndërtim.
- Impiante të prodhimit të materialeve të ndërtimit.



- Zhvillim dhe ndërmjetësim i projekteve për rikonstruksionin e ndërmarrjeve industriale.
- Kontraktimi me persona fizike dhe juridike, vendas ose të huaj për gjetjen e tregjeve të shitjes për prodhimet dhe punë të shoqërisë.
- Blerje-Shitje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme (prona të ndryshme, si troje, toka bujqësore, apartamente banimi, ambjente shërbimi dhe tregtimi etj.), pasuri këto në pronësi të shoqërisë ose në pronësi të shoqërive të tjera, personave fizike apo juridike, të cilët e autorizojnë për përfaqësim shoqërinë, për blerje-shitje.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 1.000.000 Lekë (një milion lekë) dhe është i përbërë nga një kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Bashkim Teqja**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.000.000 Lekë (një milion lekë) dhe 1.000.000 Lekë (një milion lekë) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

Z. Bashkim Teqja, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 10/09/1948, banues në Rrugen "Kostandin Kristoforidhi", Njësia Bashkiake nr.2, Godina nr.4, Kati 4, Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. Personal E80910087R, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Z. Bashkim Teqja** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

BASHKIM TEQJA

